

Silabusi i lëndës: **HIDROLOGJIA E PËRGJITHSHME**

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore		
Titulli i lëndës:	HIDROLOGJIA E PËRGJITHSHME		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II/semestri IV		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	E premte: 11.15-13.30, Dep. Gjeografisë, s.1 (L) E premte: 9.30-11.00 (lab) (U)		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. Valbon Bytyqi		
Detajet kontaktuese:	valbon.bytyqi@uni-pr.edu , https://sites.google.com/a/uni-pr.edu/valbonbytyqi/		
Përshkrimi i lëndës:	Hidrologjia është njëra nga degët e gjeografisë fizike e cila studion përhapjen e ujit në Tokë. Uji si materie e veçantë dhe më e rëndësishme në Tokë gjendet në objekte të ndryshme ujore. Andaj, Hidrologjia studion përhapjen, gjendjen e tij në natyrë, bashkëveprimet me mjediset fizike, biologjike e kimike si dhe bashkëveprimin me qeniet e gjalla. Hidrologjia shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë, bilancin ujqor, veçoritë e lumenjve, liqeneve, akullnajave, dete dhe oqeanëve, kënetave etj.		
Qëllimet e lëndës:	Studenti të kuptoj gjendjen e ujit në natyrë, qarkullimin e tij, bashkëveprimin e ujit me mjediset fizike, kimike e biologjike, shpërndarjen e ujit në natyrë. Studenti të njoh dhe përcaktoj veçoritë kryesore hidrologjike të ujit në pjesë të ndryshme të gjeosferave, si dhe relacionin e njeriut me objektet e ujore.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Të njihet me gjendjen e ujit në natyrë dhe qarkullimin e tij. • Të interpretojë ligjësitë e shpërndarjes të ujit në Tokë. • Të shpjegojë veçoritë kryesore të ujit nëpër objekte të ndryshme ujore. • Të kuptojë rolin e matjeve nëpër objekte ujore në veçanti në lumenj. • Të vlerësojë një hapësirë në aspektin hidrogeografik në relacion me faktorët tjerë fizikë (klimatikë, botanikë, gjeologjikë, pedologjikë etj.) dhe socialë-ekonomikë. • Në fund të kursit, të dëshmojë me punim seminarik karakteristikat hidrogeografike të një pellgu lumor në Kosovë. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45

Ushtrime teorike/ laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	10/semestër		10
Ushtrime në teren	15/semestër		15
Kollokuiume, seminare	30/semestër		30
Detyra të shtëpisë	15/semestër		15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	20/semestër	-	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10		10
Projektet, prezantimet, etj.	10		10
Totali			250 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutim, debate. Për ilustrim dhe përforsim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhën fotografi, ilustrime të ndryshme. Daljet në terren në të cilat do të konkretizohet njohja e karakteristikave të lumenjve dhe liqeneve duke vërtetuar dhe bërë matje.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i vazhdueshëm: <ul style="list-style-type: none"> • 40% vlerësimi i parë (java 8) • 10% aktivitete në klasë, vijim i rregullt, detyrë seminari • 50% vlerësimi i dytë (java 15). 		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • E. Haskuka – Gjeografia fizike e përgjithshme II, Gjakovë, 1997. • K. Prifti, P. Bejtja – Gjeologjia e përgjithshme (kapitulli i hidrogjeologjisë dhe i lumenjve), shblu, Tiranë, 1996. • G. Gashi – Hidrologjia (dispensë për studentë), Prishtinë, 2011 • Dingman, S.L – Physical Hydrology, 2015 • B. Shehu, K. Karanxha – Hidrologjia inxhinierike, Tiranë, 2001. 		

Literatura shtesë:		<ul style="list-style-type: none"> • H. Dakolli, Xh. Xhemajlaj: Hidrogjeologjia, Libri Universitar, Tiranë, 1997 • D. Dukić, L. Gavrilovic.: Hidrologjia, Beograd, 2008
Plani i dizajnuar i mësimit - Ligjëratat:		
Java	Data	Ligjëratat që do të zhvillohet
I	20.2.2026	Hidrologjia, objekti i studimit, lënda, definicioni ndarja, vetitë fiziko-kimike të ujit
II	27.2.2026	Cikli hidrologjik, rezervat e ujit në Tokë dhe bilanci hidrologjik
III	6.3.2026	Ujërat nëntokësorë, akuiferët
IV	13.3.2026	Ujërat nëntokësorë në terrenet karstike
V	20.3.2026	Lumenjtë, lënda, objekti, ndarja e potamologjisë
VI	27.3.2026	Rrjeti dhe sistemi lumor, tipat e rrjetit lumor
VII	3.4.2026	Ujëmbledhësi dhe ujëndarësi
VIII	10.4.2026	Shtrati dhe lugina e lumenjve
IX	17.4.2026	Hidrometria – matjet në lumenj
X	24.4.2026	Faktorët fiziko-gjeografik të regjimit të lumenjve
XI	1.5.2026	Bilanci uhor i pellgjeve lumore, elementet e bilancit
XII	8.5.2026	Akullnajat, krijimi, ortiqet
XIII	15.5.2026	Tokat me ngrirje të përhershme, kënetat
XIV	22.5.2026	Liqenet, origjina, shtrirja, bilanci uhor
XV	29.5.2026	Oqeanet dhe detet: karakteristikat hidrogeografike
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:		
<p>Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime është i obliguar si dhe respektimi i rregullave të mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.</p>		